OSSH OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES — OSHEE GROUP

**Drejtoria e Njësisë Kukës**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

*Nr. .Prot* *Kukës më datë: . .2022*

Drejtuar: *El-Power Shpk* me NIPT **L12009008K** dhe Adrese: Tirane, TIRANE, Tirane Njesia Bashkiake Nr 5, Rruga Bulevardi Bajram Curri , Ndertesa 130, Hyrja 3, Apartamenti 38, 1019.

**Lloji i procedurës së prokurimit: –**"E Hapur e thjeshtuar" me mjete elektronike.

**Numri i referencës së procedurës /Lotit:** REF-35799-07-07-2022

**Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** " Blerje mufte, koka kablli TU dhe TM"

**Fondi limit:** 3,989,700 (tre milion e nenteqind e tetedhjete e nente mije e shtateqind) leke pa tvsh.

**Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:** 60 (gjashtedhjete) dite**.**

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*):
Buletini i Njoftimeve Publike : Buletini i Njoftimeve Publike Nr.94, datë 12 korrik 2022.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto □
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. *Aci Engineering Shpk* **L51609014F**
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-t*

Vlera *:* 2,876,000 (dy milion e teteqind e shtatedhjet e gjashte mije leke pa tvsh
*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

2. BOE Boris 2019 shpk me NIPT: L96611004A dhe Ndertuesi 2014 shpk me NIPT: L46827004L
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera: *3,180,000 (tre milion e njeqind e tetedhjete mije) leke pa tvsh.*
*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

3. El-Power shpk L12009008K
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera: *3,831,000 (tre milion e teteqind e tridhjete e nje mije) leke pa tvsh.*
*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

4. ENPI shpk K41409003B
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera: *3,191,200 (tre milion e njeqind e nentedhjete e nje mije e dyqind ) leke pa tvsh.*
*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

5. SPARKLE 32 shpk L51327014R
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera*: 3,251,000 (tre milion e dyqind e pesedhjete e nje mije) leke pa tvsh*
*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. SPARKLE 32 shpk L51327014R
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet e mëposhtme*

**Drejtoria e Njësisë Kukës**

**Ne DT, shtojca 7 pika.2 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit ( kapaciteti ekonomik dhe financiar), kerkohet qe operatori ekonomik duhet të dorëzojë:**

2.1.1 Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar gjatë 2 (dy) viteve të fundit ( 2020, 2021) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogel se 30 % e vleres limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do te konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Pas shqyrtimit te dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik "Sparkle 32" përsa i përket kërkesës së Autoritetit Kontraktor nuk rezulton te jete paraqitur dokumentacion per xhiron vjetore.

Per sa me siper, me anë të dokumentacionit të paraqitur, operatori ekonomik nuk ka plotësuar kriteret e pranimit/kualifikimit, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderi.

**Ne DT, shtojca 7 pika.2.2 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit ( kapaciteti teknik), kerkohet qe operatori ekonomik duhet të dorëzojë:**

**2.2.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet te paraqese dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme,të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlere jo më e vogel se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet te paraqese vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori Ekonomik duhet te paraqese vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat,shumat dhe dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pas shqyrtimit te dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik “Sparkle 32” përsa i përket kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga dokumentacioni i paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimeve rezulton te jete paraqitur vertetim per realizim kontrate me Nr. 23/6 date 26.03.2021 me objekt “Blerje materiale elektrike, hidraulike, marangozi dhe vegla pune per specialistet”, objekti permban furnizim me materiale te ndryshme nder to dhe materiale elektrike por nga vleresimi i zerave te paraqitur ne listen bashkelidhur ne dokumentat e ngarkuara ne sistemin elektronik te prokurimeve vlera e furnizimit me materiale elektrike eshte me e vogel se vlera e percaktuar ne Dokumentat Standarte te Tenderit si deshmi per pervojen e meparshme.

Per sa me siper, me anë të dokumentacionit të paraqitur, operatori ekonomik nuk ka plotësuar kriteret e pranimit/kualifikimit, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderi.

| | | |
|---|---|---|
| 2. ENPI shpk | K41409003B | ___________________ |
| *Emri i plotë i shoqërisë* | *Numri i NIPT-it* | *arsyet e mëposhtme* |

**Ne DT, shtojca 7 pika.2.2 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit ( kapaciteti teknik), kerkohet qe operatori ekonomik duhet të dorëzojë:**

**2.2.4.** Operatori Ekonomik duhet te paraqese deklarate konformiteti ku te shprehet qe materialet te kene markim CE.

Pas shqyrtimit te dokumentacionit të paraqitur nga “ENPI” përsa i përket kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga dokumentacioni i paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimeve rezulton se nga ana e operatorit ekonomik nuk eshte paraqitur ndonje deklarate e nenshkruar prej tij persa i perket konformitetit te materialeve me markim CE sipas percaktimit DST.
Per sa me siper, me anë të dokumentacionit të paraqitur, operatori ekonomik nuk ka plotësuar kriteret e pranimit/kualifikimit, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderi.

3. BOE Boris 2019 shpk me NIPT: L96611004A dhe Ndertuesi 2014 shpk me NIPT: L46827004L

*arsyet e mëposhtme*

**Ne DT, shtojca 7 pika.2.2 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit ( kapaciteti teknik), kerkohet qe operatori ekonomik duhet të dorëzojë:**

**2.2.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet te paraqese dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme,të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlere jo më e vogel se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet te paraqese vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori Ekonomik duhet te paraqese vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat,shumat dhe dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pas shqyrtimit te dokumentacionit të paraqitur nga BOE “Boris 2019” dhe Ndertuesi 2014 përsa i përket kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga dokumentacioni i paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimeve rezulton te jete paraqitur mes te tjerash vertetim per realizim kontrate me Nr. 56 date 17.01.2022 me objekt “Mirembajtje e impjanistikes” si bashkim operatoresh mes Boris 2019 dhe Ndertuesi 2014. Ne dokumentat e dorezuara nuk eshte paraqitur marreveshja e bashkepunimit ku te shprehet % e pjesmarrjes se Operatoreve Ekonomik ne kete kontrate. Gjithashtu, ne formularin e vleresimit nuk eshte e percaktuar % e pjesmarresve ne bashkimin e operatoreve ekonomik. Ne keto rrethana nuk krijohet mundesia per te evidentuar permbushjen e ketij kriteri nga operatori ekonomik Boris 2019 per sa i perket pervojes se meparshme.

Per sa me siper, me anë të dokumentacionit të paraqitur, operatori ekonomik nuk ka plotësuar kriteret e pranimit/kualifikimit, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderi.

| | | |
|---|---|---|
| 4. Aci Engineering Shpk | L51609014F | __________________ |
| *Emri i plotë i shoqërisë* | *Numri i NIPT-it* | *arsyet e mëposhtme* |

Pas shqyrtimit te dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik “Aci engeenering” përsa i përket ofertes ekonomike ne proceduren me objekt: “ Blerje mufte, koka kablli TU dhe TM”, me fond limit: 3,989,700 (tre milion e nenteqind e tetedhjete e nente mije e shtateqind) leke pa tvsh, të shpallur nga Drejtoria Rajonale OSSH sh.a Kukës, oferta e paraqitur eshte në vlerën 2,876,000 (dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa tvsh e cila rezulton anomalisht e ulët, bazuar ne nenin 82 pika 4 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku

percaktohet se: *Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:*

- ***Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur**;*

Në mbështetje të nenit 93 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 82 pika 4 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Operatorit Ekonomik nepermjet sistemit elektronik te prokurimeve i eshte kerkuar sqarim mbi ofertën e paraqitur si dhe garantimi i furnizimit sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, me shkresen Nr. 22 Prot., date 25.07.2022 Operatori Ekonomik ne kthim pergjigje komunikon qe eshte bere nje gabim ne oferte dhe si pasoje eshte dhene gabimisht oferte e ulet.

Nga ana e Operatorit nuk eshte paraqitur sqarim mbi oferten e ngarkuar ne SPE as nuk jane sqaruar gabimet te cilat ai pohon.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktor ne kerkesen per sqarim i eshte drejtuar OE me pyetjen nese garanton furnizimin me oferten e paraqitur, Ne kthim pergjigje nuk eshte garantuar furnizimi sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Ne keto kushte, referuar dokumentacionit te paraqitur ne Sistemin Elektronik te prokurimeve gjykojme se oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik nuk kualifikohet e suksesshme per kete procedure prokurimi.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *El-Power Shpk* me NIPT **L12009008K** dhe Adrese: Tirane, TIRANE, Tirane Njesia Bashkiake Nr 5, Rruga Bulevardi Bajram Curri , Ndertesa 130, Hyrja 3, Apartamenti 38, 1019, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej *3,831,000 (tre milion e teteqind e tridhjete e nje mije) leke pa tvsh/* totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik´.

**[Titullari i Autoritetit Kontraktor]**